



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 422/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa me numër: Anr.405/2013 të parashtruar në PZAP nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP, me datë 01.11.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.405/2013, të datës 31.10.2013, të parashtruar në PZAP kundër subjektivit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e në të cilën kërkohet që të tërhiqet ankesa e lartpërmendur nga shqyrtimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje e ankesës së sipërshënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohe ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 422/2013 më datën 01.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

